



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPŠTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-052/01.0027474/25
Data.	
Data.	10. 07. 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra për Informim

Data/Date:	19.06.2025
Nga/Od/From	Grupi Punues për Dëgjime Buxhetore
Për/Za/To:	Kryetar i Komunës, z. Fadil Nura
CC	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, znj. Adelina Spahiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in 2026-2028

Duke u bazuar në nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenin 30, nenin 31 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, hartohet ky raport:

Me 06.03.2023, Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura ka formuar Grupin Punues për Dëgjime Buxhetore, në këtë përbërje:

1. **Ismet Aliu** – Drejtor për Buxhet dhe Financa, kryesues;
2. **Besart Geci** – Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar;
3. **Amir Lushtaku** – Udhëheqës i Zyrës për Informim, anëtar;
4. **Driton Mula** – Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, anëtar;
5. **Besarta Meha** – Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, anëtare;
6. **Behxhet Maliqi** – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
7. **Kastriot Duraku** – Drejtor i Drejtorisë për Arsime, anëtar;
8. **Shahin Tahiri** – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
9. **Alban Berisha** – Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
10. **Alban Shala** – Drejtor për Shërbime Publike, anëtar.

Takimet

Me 26.05.2023, është mbajtur takimi i parë i grupit punues i udhëhequr nga kryesuesi i grupit, z. Ismet Aliu dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Projekt-Propozimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 për Komunen e Skenderajt i cili është hartuar në bazë të kufijëve të

lejuar përmes Qarkores Buxhetore 2026-01, dhe në koordinim me propozimet e drejtorive komunale. Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësin e Projekt-Propozimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Grupi Punues u dakordua që Projekt-Propozimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 të dalë në diskutim publik për qytëtarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjët dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë pa dallim. Dokumenti është ngarkuar në faqen zyrtare të komunës në internet, në platformen qendrore të konsultimeve publike si dhe është publikuar njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore, që qytetarët të bëhen pjesë e vendimmarrjes. Sipas kalendarit të publikuar në faqen zyrtare dhe rrjete të ndryshme sociale, janë mbajtur dëgjimet buxhetore.

KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik u hap më 23.05.2025 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për këtë Projekt-Propozim të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente.

Publikimi në webfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Në faqen zyrtare:

<https://skenderaj.rks-gov.net/news/71959-2/>

Në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42825>

Publikimi në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1FhRkL7c28/>

KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 03 dhe 04 Qershor 2025 sipas kalendarit të publikuar janë mbajtur dëgjimet buxhetore. Të pranishëm kanë qenë qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://skenderaj.rks-gov.net/news/degjimi-i-pare-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-mbahet-ne-likoc/>

<https://skenderaj.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-i-dyte-per-kab-in-ne-bashkeine-lokale-te-cirezit/>

Konsultimi publik filloi sipas kalendarit të publikuar në vegëzën: <https://skenderaj.rks-gov.net/news/71959-2/>

Konsultimin e shpalli të hapur z. Ismet Aliu, kryesues i Grupit Punues për Dëgjime Buxhetore.

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet Bashkësia Lokale e Likofcit	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Zaim Mustafa: Në fshatin Abri e Poshtme egziston nevoja për, ndriçim publik, trotuar dhe disa rrugica të asfaltohen?	1. Driton Mulaj: Ndriçimit publik, po shpresojmë që deri nga fundi i muajit do të përfundojë pjesa më e madhe e qytetit dhe fshatrave. - Sa i përket trotuarit, ne vetëm sa jemi duke u marrë me subqendrën e Likofcit. Në kuadër të subqendrës, deri tek shkolla është i paraparë trotuari. - Për rrugë po besoj që nga fundi i qershorit planifikojmë të dalim në këtë pjesë. - Pranohet
Rizah Kadriu: A ka mundësi të na informoni për subqendrën që është duke u ndërtuar në bashkësinë lokale tonë?	2. Driton Mulaj: Subqendra është duke u ndërtuar. Objektet e vjetra do të rrënohen dhe një pjesë e subqendrës do të gjelbërohet. - Pranohet

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet Bashkësia Lokale e Qirezit	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Ismet Ademi: Në fshatin Kozhic a do të vendoset ndriçimi publik, ujësjellësi, si dhe rruga Kozhicë–Qyqavicë ka filluar por nuk ka përfunduar?	Driton Mulaj: Ujësjellësin jemi duke e shtrirë gypin kryesore. - Rrugën Kozhicë–Qyqavicë, po shpresojmë që javën e ardhshme të fillojmë. - Ndriçimi publik është duke u rregulluar në shumë fshatra. Jemi duke punuar me tre ekipe nëpër fshatra, dhe nuk po mund të dalim nga një pjesë papërfunduar në të gjitha lagjet, por gradualisht do të vijmë edhe në këto pjesë. - Pranohet
Amir Ferati: Desha ta propozoj çështjen e rrethojës së shkollës dhe oborrit të shkollës, pasi që është interes i të gjithëve.	Kastriot Duraku: Rrethojën e kemi diskutuar me drejtorin disa herë, por këtë vit është problem të punohet diçka. Por për vitin e ardhshëm, si projekt është i qelluar. - Pranohet
Afrim Rama: Desha të pyes për trotuar, pasi që lagjja jonë nuk ka as edhe një 1 metër trotuar?	Driton Mulaj: Për trotuar e kemi në kuadër të fshatit Qirez, një pjesë kogja të mirë. - Pranohet
Ismet Ademi: Deshta të ngre edhe një çështje tjetër për një situatë me kanalizimin te lagjja Jasharaj në Kozhicë, pasi ka dalur kanalizimi në një arë dhe kundërmon shumë, është nevojë e domosdoshme të rregullohet.	Driton Mulaj: Sa i përket kanalizimit, tash kompania është në fshatin Qubrel, sapo ka përfunduar, pasi që në këtë fshat kemi hasur me disa telashe, por i kemi përfunduar. Dhe nuk kemi mundur të vijmë papërfunduar këtë fshat, kështu që para fundit të muajit qershor do të fillojë edhe sanimi i problemit në këto pjesë. - Pranohet

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet Bashkësia Lokale e Turiqecit	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Bleard Osmani: A do të bëhet asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Turiqec ?	Driton Mulaj: Po, asfaltimi i rrugicave në fshatin Turiqec është i paraparë dhe do të realizohet. - Pranohet

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Bashkësia Lokale e Runikut	
Ergin Smakaj: Përshëndetje për të gjithë, unë kam një kërkesë rreth ndriçimit publik, a do të vendoset në lagjen tonë?	Driton Mulaj: Ndriçimi publik është në proces rregullimi në shumë fshatra; ndër to, edhe në fshatin Kllodernicë dhe lagjen tuaj do të bëhet vendosja e tij. - Pranohet

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Bashkësia Lokale e Klinës së Epërme	
Sami Tahiraj: Desha të pyes, kush i vendos shenjat e komunikacionit?	Driton Mulaj: Sami, vendosjen e shenjave të komunikacionit në rrugët magjistrale e bën Ministria, ndërsa në rrugët lokale i vendos Komuna përmes operatorit të kontraktuar. - Pranohet
Kastriot Osaj: Ne si lagje kemi mungesë të trotuarit në rrugën kryesore. Po ashtu, nuk ka përfunduar ndriçimi publik.	Driton Mulaj: Sa i përket ndriçimit, punimet janë duke vazhduar, por pas përfundimit të shtrirjes duhet të merret një pëlqim nga KEDS-i dhe ky pëlqim po vonon shumë. Megjithatë, do të përfundojnë të gjitha lagjet. - Sa i përket trotuarit, për pjesën lart që e kemi vazhduar kemi pasur disa probleme me Ministrinë, por besoj se do ta realizojmë. - Pranohet
Kastriot Osaj: Kush do ta bëjë mirëmbajtjen e subqendrës pasi të ndërtohet?	Driton Mulaj: Kastriot, pas pranimin teknik, operatori do ta mirëmbajë subqendrën për një vit, ndërsa pas një viti mirëmbajtjen do ta marrë “Eko Natyra”. - Pranohet

Komentet – Janë dhënë gjithsej 11 komente, prej të cilave 11 janë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
------	------	-------------	------------	----------	--

Projekt - Propozim i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	46	https://skenderaj.rks-gov.net/news/71959-2/	11 kërkesa Të gjitha kërkesat janë marrë për bazë.	1. https://skenderaj.rks-gov.net/news/71959-2/ 2. https://skenderaj.rks-gov.net/news/degjimi-i-pare-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-mbahet-ne-likoc/ https://skenderaj.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-i-dyte-per-kab-in-ne-bashkeine-lokale-te-cirezit/
--	-----------------------------------	----	---	---	---

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emaillet e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike për këtë Projekt-Propozim të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Grupi Punues takimin e fundit e ka mbajtur me datë 04.06.2024 në të cilin janë diskutuar komentet e mbledhura. Kryesuesi i Grupit Punues, z. Ismet Aliu ka thënë që të gjitha komentet që janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik janë të përfshira dhe janë pjesë e tij. Meqë faza e konsultimit publik ka përfunduar, atëherë unë në emër të këtij komisioni, një raport mbi procesin e konsultimit publik do të ja dërgoj Kryetarit të Komunës dhe me siguri që ky Projekt-Propozim i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, do të dërgohet shpejt për miratim në Kuvendin e Komunës.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Vendimi për caktimin e Grupit Punues

Njoftimin publik për konsultimin publik

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik

Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

Ismet Aliu
Kryesues i Grupit Punues






Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për KAB 2026-2028

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e KAB (Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028).

KAB-i është dokument i rëndësishëm për planifikimin e buxhetit dhe hartimin e listës së investimeve kapitale kurse përmes dëgjimeve buxhetore qytetarët bëhen pjesë e vendimmarrjes. Këto dëgjime do të mbahen me datat 3 dhe 4 Qershor 2025 sipas kalendarit të mëposhtëm. Në këto dëgjime buxhetore mund të marrin pjesë: qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë të tjerë pa dallim.

Dëgjimi buxhetor	Dita/data e mbajtjes	Vendi	Ora
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Likofcit	E martë, 03 Qershor 2025	SHFMU "Fehmi Rama", Likofc	13:30
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Qirezit	E martë, 03 Qershor 2025	SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës", Qirez	15:00
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Turiqefcit	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Abedin Rexha" Turiqefc	13:30
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Runikut	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Shotë Galica", Runik	15:00
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Klinës së Epërme	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Idriz Barani"	16:00

Për më shumë detaje, për Qarkoren buxhetore përmes të cilës hartohet Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Skenderajt mund të vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Qarkorja-Buxhetore-2026-01_SE-komente_07052025.-shqip.pdf

Platforma qendrore e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42825>

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në emailat: ismet.aliu@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.



Amir Lushtaku

Udhëheqës i Zyrës për Informim



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENTI KOMUNAL
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0008208/25
Data.
Data. 06.03.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13, nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 37 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
(Për themelimin e Grupit Punues)

I. Themelohet Grupi Punues Përgjegjës për Dëgjime Buxhetore, në këtë përbërje:

1. Ismet Aliu – Drejtor për Buxhet dhe Financa, kryesues;
2. Besart Geci – Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar;
3. Amir Lushtaku – Udhëheqës i Zyrës për Informim, anëtar;
4. Driton Mula – Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, anëtar;
5. Besarta Meha- Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, anëtare;
6. Behxhet Maliqi – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
7. Kastriot Duraku – Drejtor i Drejtorisë për Arsimit, anëtar;
8. Shahin Tahiri – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
9. Alban Berisha – Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
10. Alban Shala – Drejtor për Shërbime Publike, anëtar.

II. Detyrë e grupit punues nga pika I e këtij vendimi është identifikimi i grupeve të qytetarëve, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore, materialeve dhe informacioneve të nevojshme, pastaj prezantimi i informacioneve të buxhetit, ndarja e listave të pjesëmarrësve, moderimi i takimeve, përpilimi i kriterëve për shqyrtimin e kërkesave, shqyrtimi i kërkesave, hartimi i raportit përfundimtar dhe publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës, sipas afateve të përcaktuara me UA për Administratë të Hapur në Komuna.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuesit të grupit punues
- Anëtarëve të grupit punues

Kryetari i Komunës

Fadil Nura